

**KRIJIMI DHE EVOLUIMI STRUKTUROR I ARKIVIT TË  
SISTEMIT NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME  
1964-1993**

**Përmbledhje**

Krijimi dhe strukturimi i arkivit të sistemit në Ministrinë e Integritit dhe Punëve të Jashtme që nga fillimi i aktivitetit të saj, menjëherë pas mbarimit të Luftës së II Botërore, bëri të mundur të konsolidohej si një arkiv sistemi duke i dhënë një dimension të ri shërbimit arkivor shqiptar në tërësinë e saj. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme jo vetëm që përmban një histori shumë interesante, por mendoj se dokumentet që janë pranë këtij arkivi duhen shfrytëzuar më shumë nga studiuesit, edhe pse në vitet e fundit ka një rritje të tyre, nisur edhe nga faktorët historiko-politikë që vendi ynë ka kaluar përgjatë historisë. Shpërfaqja e temës bën të mundur një njohje modeste të historikut në fjalë që nga viti 1964, pra me krijimin e tij si arkiv sistemi, deri në vitin 1993 kur ndryshimi i sistemit politik sjell pasoja edhe në ndryshimet ligjore të AHMPJ-së

**Fjalët kyçe:** *arkiv, dokumente, evoluim, historik, Ministria e Jashtme, strukturë*

**Abstract**

The creation and the structuring of the archive of system in ministry of integration and foreign office, since the beginning after the and of the Second World War, made it possible to consolide like an new system archive giving another dimension of albanian service.

The archive of this ministry not only contain a history very interesting, but I think that documents that are at this archive have to be more used from the researches even why recent years have had their increase, strating from the historical – politics factors, that our contry has passed throught history.

The representation of the topic makes a modest recognition of history in the speech since 1964. So with its creation as an archive system, until 1993 where the changement of the politic system would bring cosenquences for legal changes of Archives of Forin Office.

**Keywords:** *archive, documents, evolution, foreign office, structur*

Që në fillesat e tyre çdo rend pushtetar i ka kushtuar rëndësi ruajtjes së historisë që ka përjetuar. Ndër shekuj ata kanë mbledhur dhe ruajtur me fanatizëm arkivin dokumentar, duke arritur deri në ditët e sotme gjë që ka bërë të mundur evidentimin e historisë.

Edhe Shqipëria përgjatë shekujve ka krijuar fizionominë e një arkivi historik, kurse në vitin 1949 themelon Arkivin Shqiptar.

Krijimi i Arkivit të Sistemit të MPJ trajton historikun e krijimit të Arkivit Shqiptar në vitin 1949, duke qenë edhe themel i arkivave të tjera që do të ngriheshin në vitet e mëvonshme. Puna e madhe që do të bëhej për ngritjen e këtij institucioni bëri të mundur që të evidentohej edhe me ngritjen e rrjetit arkivor, duke mos u stacionuar jo vetëm brenda kryeqytetit shqiptar, por edhe në rrethet e tjera, në institucionet kryesore perkatëse. Ky arkiv do të sillte një lehtësim në radhë të parë për shfrytëzimin e materialit arkivor jo vetëm për vetë institucionin në fjalë, por edhe për studiuesit e jashtëm.

Punimi mbi këtë arkiv solli vetëm disa nga aspektet më kryesore që ky arkiv ka kaluar ndër vite. Konsultimi i dokumenteve të shumta pranë këtij arkivi bëri të mundur një njohje sa më të thellë të gjithë punës që është bërë deri më sot, duke filluar që me organikën. Pra, punonjësit në fjalë, të cilët edhe pse pa një njohje të saktë të fushës përkatëse, arritën që me punën e tyre vetëmohuese, e them dhe e nënvizoj këtë përkufizim, ta përsosnin aktivitetin duke bërë që AHMPJ të jetë një nga arkivat më unike në llojin e vet.

### **1.1. Gjendja arkivore në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore**

Nëntor 1944. Tirana tashmë po përjetonte ditët e fundit të luftimeve. Ishte më se e qartë që rrjedha e luftës po merrte kahun e fitimtarëve në Evropë dhe të Nacionalçlirimtares në Shqipëri. Mes porosive që Shtabi i Përgjithshëm jepte një nga detyrat kryesore ishte mbledhja e dokumentacionit pasi kjo përbënte një rëndësi tejet të veçantë. Rëndësia e kësaj porosie qëndron në faktin se ndër detyrat e para të çdo shteti është krijimi i bazës së çdo dokumentacioni të lidhur me institucionet ekonomike, të pronësisë, financat dhe strukturat e mëparshme.

Në këto kushte detyrë parësore ishte grumbullimi dhe përqendrimi i dokumenteve dhe krijimi i një organi qendror arkivor. Përpjekjet për realizimin e kësaj detyre kishin filluar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, por ato u shtuan pas saj. Për këtë detyrë u angazhuan organet shtetërore, kryesisht Instituti i Studimeve.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Pela Mihallaq, *Shërbimi arkivor shqiptar*, Gërmis, 2001, f. 4

Pas disa viteve kjo e fundit do të konkretizohej në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr. 21, dt. 8 qershor 1949: “Në bazë të kësaj urdhërese u krijua Arkivi Shqiptar si person juridik që do të merrte përsipër administrimin e Fondit Arkivor”.

Çfarë përmbante ky fond dhe si funksiononte? Për sa i përket këtij fondi u konceptua si pasuri shtetërore. Për herë të parë hidhet ideja që “... dokumentet janë pasuri kombëtare dhe mbrohen në bazë të ligjit të shtetit”, ide këto që do ta përbëjnë themelimin e dispozitave të ardhme për Fondin Arkivor Kombëtar dhe për arkivat.

Në vitin 1948 pranë Degës së Historisë në Institutin e Studimeve krijohet Arkivi i Dokumenteve Historike i cili “... gjatë gjysmës së parë të vitit 1949 grumbulloi një sasi të madhe dokumentesh me karakter historik që të ruheshin në institucione apo nga persona të veçantë... para vitit 1944”.<sup>2</sup> Ky arkiv përmbante dokumente të para viteve '20, ku deri në atë çast i gjithë ky dokumentacion ruhej në disa institucione siç ishte Biblioteka Kombëtare, në kuvendet e jezuitëve dhe të françeskanëve në Shkodër etj.

Puna që arkivi i shtetit bëri, edhe pse në Institutin e Studimeve, ishte e madhe, duke mbledhur dokumentacion historik, siç ishin fondet para vitit 1912, të organizatave, të shoqatave, sidomos të klerit katolik.

Në bazë të një promemorie të Institutit të Historisë nr. 15, dt. 29.07.1947, që i drejtohej Këshillit të Ministrave, thuhej: “Të grumbullohen nga arkivat... materiali që shkon deri në nëntor 1944, ku mbyllet faza e shtetit të vjetër dhe fillon administrata e re e pushtetit popullor”.<sup>3</sup>

Në një tjetër promemorie të vitit 1951 nga Instituti i Shkencave jepen indikacione të ndryshme... “ku duhen përqendruar kërkimet për grumbullimin e dokumenteve jashtë shtetit”.<sup>4</sup>

Nga viti 1951-1960 puna u përqendrua më tepër për hartimin e dispozitave të punës arkivore dhe në grumbullimin e dokumenteve në Arkivin e Shtetit.

“Krijimi i Drejtorisë së Arkivave dhe parashikimi me rregullore i krijimit në të ardhmen, përveç Arkivit Shtetëror dhe i Arkivave Shtetëror Lokale, krijon një tablo të plotë të rrjetit arkivor në vendin tonë.”<sup>5</sup>

## **1.2 Krijimi i Arkivit të Sistemit në MPJ, mars 1964**

Strukturën e parë organizative të MPJ e ndeshim në vitin 1923. Ajo përbëhej nga 15 pozicione pune dhe mes tyre ndeshim edhe pozicionin e

---

<sup>2</sup> Po aty f. 13

<sup>3</sup> Po aty f. 23

<sup>4</sup> Po aty f. 23

<sup>5</sup> Po aty f. 23

arkivistit. Ky pozicion ishte pjesë e vazhdueshme e strukturave në vazhdim të MPJ, derisa u institucionalizua edhe me Ligjin Organik të Ministrisë së Punëve të Jashtme në prill 1929. Ky ligj përbënte shtyllën vertebrale të funksionimit të shërbimit të jashtëm shqiptar.

Hapat e parë mbi krijimin e arkivit historik pranë MPJ i ndeshim që në vitin 1947, ku në një qarkore të kryeministrisë drejtuar gjithë ministrive dhe institucioneve shtetërore dhe vendore thuhet: “Me urdhër të kësaj kryesie pranë MPJ është krijuar Arkivi Historik ku do të grumbullohet me qëllim klasifikimi dhe studimi e gjithë arkiva e zyrave të ndryshme të okupatorëve italo-gjermanë. Të mos shkatërrohet, digjet ose flaket ky material në asnjë mënyrë.”<sup>6</sup>

Si në çdo fillim, organizimi i punës së një institucioni, sistemimi i dokumenteve ishte objektivi kryesor edhe në arkivin e sapokrijuar të MPJ. Me kalimin e viteve rritja e dokumenteve kërkonte një domosdoshmëri në klasifikimin e saj, pasi kjo do të shërbente në shfrytëzimin sa më efikas të tij.

Shërbimi që operohej në këtë arkiv ishte i një metode jo të përshtatshme, prandaj që puna të bëhej, në mënyrë të rregullt dhe komfort standardeve, u përgatit një skedar që do të ishte çelës i punës: “Sepse do të lejojë gjetjen e numrit rendor të çdo dokumenti me shpejtësinë dhe lehtësinë më të madhe. Skedat do të radhiten sipas rendit alfabetik”.<sup>7</sup>

Organika e parë e plotë dhe e përgatitur në përputhje me hapësirat dhe orientimet e politikës së jashtme shqiptare të asaj kohe konsiderohet ajo e vitit 1947, vit kur edhe sistemi politik i shtetit monist u instalua plotësisht. U aprovua e para Rregullore mbi Organizimin e MPJ të RP të Shqipërisë e cila u miratua nga Këshilli i Ministrave më 7 korrik 1947.

Në vitin 1954 doli Seksioni Sekret dhe Arkiva, i përbërë nga 12 veta.

Ndërkohë MPJ arkivonte vetëm informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” me përdorim shumë të kufizuar dhe të autorizuar vetëm për punonjësit e shërbimit të jashtëm.<sup>8</sup>

Rreth viteve '60, duke parë konsolidimin e arkivit në fjalë, në një inspektim të bërë nga kjo drejtori, u vu në dukje puna e kryer e sektorit të arkivit në fjalë. Çështja në fjalë ishte mbi ndarjen e dokumentacionit në tri grupe: A B dhe C. Të tria këto ndaheshin sipas koncepteve të ndryshme: në grupin A futeshin dokumentet mbi marrëdhëniet politike, në grupin B marrëdhëniet konsullore dhe grupi C çështje të ndryshme.

---

<sup>6</sup> Po aty f. 35

<sup>7</sup> Po aty f. 35

<sup>8</sup> Pranvera Dibra, *Arkivi historik i diplomacisë shqiptare, Vjetari*, botim i Agjencisë Shtetërore i Arkivave i Kosovës, 2016, f. 533

“Në kapakun e dosjes janë shtuar grupi --- ku duhet të shënohet grupi a, b dhe c, kujt i takojnë dokumentet në atë dosje si dhe “nr. art. Sipas listës tip” të afateve të ruajtjes”.<sup>9</sup>

“Me vendimin e qeverisë shqiptare nr.89, dt.21.9.1964 “ mbi krijimin e arkivave të MPB-MBP dhe MPJ” u krijua arkivi i sistemit të MPJ. Sipas pikës 3 të këtij vendimi “ ...arkivat që krijohen sipas këtij vendimi administrojnë të gjitha materialet dokumentare të sistemit të organeve të tyre”.<sup>10</sup>

Përse ishte i rëndësishëm kalimi i dokumentacionit në MPJ? A pati impakt ardhja e tij afër? Sepse në politikën e jashtme problemet kanë vazhdimësi, pra çdo problem ka dhe historikun e vet.

MPJ krijoi arkivin e saj në varësi të MPJ-së, por pa bërë shtesa në organikën e institucionit. Puna arkivore si fillim do të kryhej nga të gjithë diplomatët e drejtorive të tjera në MPJ duke punuar përkohësisht nga 2-3 muaj në arkiv. Arkivi shtetëror detyrohej t'i dorëzonte arkivit MPJ “ ... të gjitha materialet që kishin hyrë në sistemin e MPJ për periudhën pas çlirimit”.<sup>11</sup>

Në vitin 1970 organizohet konsulta e parë rreth organizimit të informacionit shkencor, duke përcaktuar detyra të ndryshme, sidomos për arkivat në veçanti dhe ritmin në përpunimin tekniko-shkencor.

“Në zbatim të udhëzimeve të dhëna nga udhëheqja e lartë e vendit, në vend të Degës së Arkivit Historik, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 164, dt. 05.10.1973, “për krijimin e Byrosë së Studimeve dhe Dokumentacionit në MPJ”, e cila filloi aktivitetin më 1 nëntor 1973.<sup>12</sup>

“Kjo byro do të kishte dy sektorë: Sektorin e Sistemit Shkencor dhe të Botimeve, dhe Sektorin e Sekretarisë Sekrete. Drejtori i Byrosë së Studimeve dhe Dokumentacionit emërohej gjithmonë nga radhët e ambasadorëve”.<sup>13</sup>

Në vitet 1980-1981 dy ngjarje do të shënoheshin për arkivistikën shqiptare: ngritja e arkivit historik dhe Ligji mbi shfrytëzimin e pasurive arkivore. “... në gjysmën e parë të viteve '80 u krijua Dega e Arkivit Historik, ku Sektori i Studimeve dhe i Botimeve ishte pjesë e tij”.<sup>14</sup>

Këto ishin disa nga hapat e para të punës që u ndërморën në arkivin historik të MPJ.

---

<sup>9</sup> AHMPJ, v. 1963, d. 1046, fl. 6

<sup>10</sup> Gjet Ndoji, *Arkivat shqiptare, Dita Print*, Arkivi Shtetëror i Sistemit të MPJ-së, 2017, f. 71

<sup>11</sup> Po aty f. 71

<sup>12</sup> Po aty f. 71

<sup>13</sup> Po aty f. 71

<sup>14</sup> Po aty f. 71

### 1.3 Skema e klasifikimit dhe gjendja e përpunimit të dokumentacionit në punimin shkencor

Në vitin 1963, DPA, për ta rritur sa më shumë nivelin e punës në trajtimin e dokumentacionit në arkivat e institucioneve, organizon një kontroll, përfshirë këtu edhe MPJ-në. Në bazë të kontrollit të ushtruar u arrit në konkluzionin që problemi më kryesor në funksionimin sa më profesional të punës ishte skema e klasifikimit, pasi metodologjia e punës varej pikërisht te skemat e klasifikimit. Por cilat ishin fillimet e kësaj skeme?

Në fillim ka qenë me gurmë, sipas rendit alfabetik. Këtu përfshiheshin edhe katalogët. Në fillim katalogët kanë qenë në drejtori, p. sh., vendet lindore me ato përfundime ishin bashkë.

“Me kalimin e kohës MPJ zgjeronte aktivitetin diplomatik dhe si pasojë u rrit shumë sasia e dokumentacionit që krijohej dhe grumbullohej në ambientet e Zyrës Sekrete. Lindi nevoja e një aktiviteti shtesë: ai i klasifikimit sistematik dhe krijimi i mundësisë për shfrytëzimin e tij si material reference për praktikën e ardhshme dokumentare”.<sup>15</sup>

“Tashmë dokumentacioni i krijuar nga shërbimi i jashtëm ndahej në tri grupe të mëdha: A - dokumente mbi marrëdhëniet politike e ekonomike; B - dokumente mbi marrëdhëniet konsullore; dhe C - arkiva ordinere. Çdo grup dokumentesh ndahej sipas degëve të veprimtarive, shteteve, viteve dhe çështjeve. Çdo dosje kishte një organizim kronologjik, një përshkrim mbi kapakun e dosjes dhe një formular të sasisë së dokumentacionit”.<sup>16</sup>

#### **Kronologji - strukturë**

Kjo skemë ka përdorim të gjerë si për institucionet në veprim, po ashtu edhe për fondet e mbyllura. Kjo skemë ruan lidhjen sipas kohës dhe prejardhjes; është e lehtë për zbatim praktik dhe krijon kushte të favorshme për shfrytëzimin e dokumenteve. Sipas kësaj skeme, të gjitha dokumentet që ndodhen në sekretari apo arkiv fillimisht klasifikohen (grupohen) sipas viteve e më tej sipas strukturave (drejtori, degë etj.).

“Duke u mbështetur në vendimin e K. Ministrave lidhur me ngritjen e arkivit në MPJ me eksperiencën e këtyre dy institucioneve qendrore, pasi i shqyrtoam edhe materialet që ne disponojmë, me qëllim që të mbetet i njëjti sistem në të gjithë Republikën lidhur me ruajtjen e dokumenteve

---

<sup>15</sup> Pranvera Dibra, *Arkivi historik i diplomacisë shqiptare, Vjetari*, botim i Agjencisë Shtetërore i Arkivave i Kosovës, 2016, f. 535

<sup>16</sup> Po aty f. 535

arkivale, mendojmë se ky kriter, dmth. kronologji - strukturë i përshtatet fare mirë edhe dikasterit tonë”.<sup>17</sup>

Në vazhdimin e informacioneve që jepeshin mbi gjendjen e arkivit të institucionit në fjalë, përsëri çështjet thelbësore kishin si synim skemat e reja që mund të gjendeshin në përmirësimin e punës arkivore. Kështu, në informacionin në fjalë, Mikail Çobani, (ish-drejtor i Arkivit pranë MPJ në vitet '60), jep një kuadër specifik mbi punën e bërë.

“Arkiva në fillim ka qenë e ndarë sipas sistemit austriak (vitet 1945-1953), pastaj u fut sistemi sovjetik. Të dyja u bashkuan kur filloi sistemi i përgjithshëm i dokumenteve të vitit 1960-1962, sipas skemës së vjetër u pat parasysh vendosja e dokumenteve, viti, shteti, çështja”.<sup>18</sup>

Sa më shumë që shkenca e arkivistikës zhvillohet, aq më shumë bëhej më e mirë skema.

“Në vitin '72 nga ministri u miratua lista e parë zyrtare me afatet e ruajtjes së dokumenteve në shërbimin e jashtëm, ndërsa më '73 kemi edhe skemën e parë të klasifikimit shkencor të dokumentacionit sipas problematikës së politikës së jashtme për kohën dhe llojin e detyrave”.<sup>19</sup>

E një rëndësie të veçantë ishte edhe mbushja e skedave, në të cilat titulli ishte i shkurtër dhe përmbledhës. “Kur skeda ka për bazë dosjen, titulli i skedës do të jetë i njëllotë me atë të dosjes. Kur skeda përfshin disa dosje, bëhet përgjithësimi i tyre me titullin që do të shkruhet në skedë”.<sup>20</sup>

Mikrofilmimi i dokumenteve të Arkivit Historik të Ministrisë së Punëve të Jashtme ishte një tjetër proces që filloi në vitin 1984. Procesi në fjalë filloi me mikrofilmimin e marrëveshjeve dypalëshe të hartave etj., por ideja për mikrofilmimin e dokumentacionit ishte hedhur që në vitin 1965, pasi shikohej rëndësia e procesit.

“... mund të jetë nevoja e mikrofilmimit të dokumenteve në perspektivë”.<sup>21</sup> Sipas rregullores së mikrofilmimit, çdo dokument mikrofilmohej në tri kopje. Dy prej tyre ishin në ruajtje të përhershme, ndërsa kopja e tretë në formë xhakete shfrytëzohej nga studiuesit.

“Në vitin e kaluar erdhën nga jashtë pjesa më e madhe e aparaturave të porositura për laboratorin e mikrofilmimit të dokumenteve arkivale, me përjashtim të aparatit larës OMAG dhe të fotokopjueses së filmit në letër. Gjithashtu, erdhën edhe të pesë dollapët për mbajtjen e filmave si dhe një arkë me 100 bobina filmi nga 30 m secila”.<sup>22</sup>

---

<sup>17</sup> AHMPJ, v. 1966, d. 403, fl. 9

<sup>18</sup> AHMPJ, v. 1971, d. 824, fl. 5

<sup>19</sup> AHMPJ, v. 1973, d. 861, fl. 70-94

<sup>20</sup> AHMPJ, v. 1974, d. 583, fl. 4

<sup>21</sup> AHMPJ, v. 1965, d. 656, fl. 13

<sup>22</sup> AHMPJ, v. 1978, d. 18, fl. 4

Ngritja e një objekti bashkëkohor si vend ruajtjeje i dokumenteve arkivore të Arkivit Historik të MPJ-së pati një rëndësi të madhe, meqë lehtësonte punën në mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe sigurinë e tij kombëtare. Ndërtimi i këtij objekti ishte përcaktuar brenda territorit të vendstrehimit të materialeve të Këshillit të Ministrave. Ishte e nevojshme të njihej sasia e materialeve arkivale që duhej futur brenda në mënyrë që të mund të llogaritej kapaciteti i godinës.

Fillimet mbi idetë dhe projektin e ndërtimit të objektit në fjalë fillojnë që në vitin 1979, ku në një informacion i Byrosë së Studimeve nënvizohet, midis të tjerash, mbi demarshet që duhen bërë për ngritjen e godinës ku do të vendosej Fondi Arkivor i MPJ-së.

“Duke marrë parasysh se materialet arkivale të MPJ-së kanë rëndësi të veçantë dhe janë me vlerë, propozojmë që ato të ruhen brenda territorit të vendstrehimit të Kryeministrisë, duke krijuar për to një godinë të veçantë...”<sup>23</sup>

Por në një shkresë të Këshillit të Ministrave të vitit 1978, drejtuar Ministrisë së Ndërtimit (Instituti të Projektimit, nr. 1) është ky vendim: “Në vendimin nr. 132, datë 01.07.1978 të Këshillit të Ministrave, përcaktohet që Ministria e Punëve të Jashtme do të ketë një godinë e veçantë për ruajtjen e Fondit Arkivor të saj”.<sup>24</sup>

Godina ku do të ruheshin dokumentet arkivore të MPJ-së do të ndërtohej në rrethin e Gramshit.

Objekti Y i përshtatej një vendi të ruajtjes dinjitoze. Por, kjo ka qenë politikë e shtetit. Ishte një evolucion në mentalitetin për arkivat që të kishin një objekt cilësor, modern të ruajtur mirë.

### **1.5 Vendi i Arkivit Historik në fillim të viteve '90**

Proceset politike që po zhvilloheshin vrullshëm në Evropën Lindore, si rënia e murit të Berlinit në Gjermani, ekzekutimi i diktatorit Çausheku në Rumani etj., bënë që edhe në Shqipëri ngjarjet të merrnin një rrjedhë tjetër. Edhe në institucionet shtetërore po dukeshin qartë hapat e parë të menaxhimit të situatave të reja që paraqiteshin pranë tyre.

Arkivi Historik tashmë me fizionominë e vet të konsoliduar prej vitesh po përpiquej të krijonte një hapësirë për t'iu përshtatur më mirë kërkesave që parashtronte koha. Një nga objektivat e arritura ishte edhe instalimi i terminalit në ministri duke lehtësuar punën e dokumenteve për problemet operative dhe ato studimore.

---

<sup>23</sup> AHMPJ, v. 1985, d. 1513, fl. 1

<sup>24</sup> Po aty fl. 2

“Kryesisht në terminal do të hidhen të dhëna të ndryshme të përpunuara si administrative, informative dhe pjesërisht nga Arkivi Historik. Ashtu si të gjitha institucionet e tjera, edhe Ministria e Jashtme do ta ketë vendin e vet”.<sup>25</sup> Por, mbi të gjitha, theksi vihej mbi shfrytëzimin e materialeve dokumentare si nga studiues të brendshëm dhe të jashtëm.

“Një volum i madh pune është kryer gjatë këtij viti për përgatitjen dhe furnizimin me material arkival për studiuesit e ndryshëm në ministri. Materiale të tjera janë nxjerrë për konferencën ballkanike dhe aktivitete të tjera...”.<sup>26</sup>

“Ndërsa për shkak të ndryshimeve politike në vend, në gjysmën e dytë të vitit 1992, në kuadër të rishikimit të legjislacionit, DPASH e rimori në shqyrtim Projektligjin e titulluar ‘Për Fondin Arkivor Kombëtar dhe Arkivat e Shqipërisë’, duke e zgjeruar më tepër sferën e veprimit të tij në këtë fushë. Miratimi i tij u arrit më ’93 me ligjin nr. 7726, dt. 29.06.1993 ‘Për Fondin Arkivor dhe për Arkivat’, ku AMPJ, AMPB dhe AMM konsideroheshin arkiva sistemi që do të vareshin nga ministria përkatëse, ndërsa nga ana metodologjike do të merrnin udhëzime nga DPA”.<sup>27</sup>

Rishikimi i legjislacionit, përveç udhëzimeve bazë që kishin të bënin me arkivat, do të ndryshonte dhe në brendësi duke sjellë risi në disa prej tyre, siç ishte shfrytëzimi i materialeve dokumentare. Nëse deri para një viti (1991) ekzistonte një “kasafortë” për ruajtjen e dokumentacionit, tashmë rrugët për shfrytëzimin e tyre ishin hapur.

Po si paraqitej situata e përgjithshme në Degën e Arkivit Historik dhe cili ishte pozicionimi i saj në strukturën e MPJ-së?

Në kuadrin e reformimit brenda MPJ-së, me supremimin e Komitetit të Marrëdhënieve me Botën e Jashtme dhe krijimin e Drejtorisë së Kulturës pranë ministrisë në fjalë, i gjithë dokumentacioni i Komitetit i kaloi Arkivit të MPJ-së. Por, krahas ndryshimeve dhe punës që bëhej në degën e arkivit, evidentoheshin edhe gabime, siç ishte praktika e dorëzimit të dokumentacionit.

“Praktika e deritanishme e dorëzimit të dokumenteve nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur evidentimit të tyre dhe përcaktimit të saktë të përgjegjësive. Prandaj mendojmë që për të shmangur çdo anomali në këtë drejtim, punonjësi i sekretarisë të kërkojë me rigorozitet zbatimin e këtyre rregullave: Plotësimin e dokumenteve sipas rregullave në bazë të formulimit të shkresave zyrtare”.<sup>28</sup> Këto kushte u kërkoreshin edhe përfaqësive tona

---

<sup>25</sup> AHMPJ, d. 1716, v. 1988, fl. 1

<sup>26</sup> AHMPJ, d. 715, v. 1988, fl. 27

<sup>27</sup> Pranvera Dibra, *Arkivi historik i diplomacisë shqiptare, Vjetari*, botim i Agjencisë Shtetërore i Arkivave i Kosovës, 2016, f. 535

<sup>28</sup> AHMPJ, d. 1046, v. 1993, fl. 6

diplomatike të akredituara jashtë lidhur me dorëzimin e dokumenteve përkatëse.

Mbledhja e dokumenteve nga burime të ndryshme për pasurimin e arkivit si nga sekretaria, kabineti i ministrit etj., do bëhej gjithmonë sipas afateve të caktuara, duke përfshirë klasifikimin në bazë të një skeme, emërtimin e çdo dosje, organizimin e brendshëm të saj etj.

Në përfundim mund të thuhet që Arkivi i MPJ-së, me gjithë ndryshimet që pësoi në vitet e para të tranzicionit, nuk e humbi vlerën dhe rëndësinë e Arkivit Historik me të gjithë parametrat e duhura bashkëkohore.

## **Referenca:**

### *Burime parësore:*

- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1963, D. 1046
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1966, D. 403
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1971, D. 824
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1973, D. 861
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1974, D. 583
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1965, D. 656
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1978, D. 18
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1985, D. 1513
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1988, D. 716
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1988, D. 715
- Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme, V. 1993, D. 1046

### *Burime dytësore:*

- Pela, Mihallaq, *Shërbimi arkivor në Shqipëri, 1945-1990*, Gervis, 2001
- Dibra, Pranvera, *Arkivi historik i diplomacisë shqiptare, Vjetari*, botim i Agjencisë Shtetërore i Arkivave të Kosovës, 2016
- Ndoji, Gjet, *Arkivat shqiptare, Dita Print*, 2017